



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 21

Tiranë – E premte, 22 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 1/2019 datë 31.1.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar”..... 733
Ligj nr. 4/2019 datë 7.2.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar..... 733
Ligj nr. 5/2019 datë 7.2.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”..... 737
Ligj nr. 6/2019 datë 7.2.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë..... 738
Ligj nr. 7/2019 datë 14.2.2019	Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut..... 745
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 56, datë 15.2.2019	Për shpalljen e ndryshimeve të standardit kombëtar të kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”, i përmirësuar”..... 746
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 88, datë 18.2.2019	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 41, datë 24.1.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”.... 746

**LIGJ**
Nr. 1/2019**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2,
DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 109/2017
“PËR BUXHETIN E VITIT 2018”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 19.12.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar”.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 31.1.2019

LIGJ
Nr. 4/2019**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 64/2012, “PËR
PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) nr. 1379/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1184/2006 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 104/2000”, të ndryshuar. Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354, datë 28.12.2013, faqe 1–21.
- Rregulloren (BE) nr. 508/2014, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit” dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KE) nr. 2328/2003, (KE) nr. 861/2006, (KE) nr. 1198/2006 dhe (KE) nr. 791/2007 dhe Rregulloren (BE) nr. 1255/2011, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”. Numri CELEX 32014R0508, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 149, datë 20.5.2014, faqe 1–66.”.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës” zëvendësohet me emërtimin “Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 22 shtohen pikat 22/1 dhe 22/2 me këtë përmbajtje:

“22/1. “Infrastruktura e peshkimit” është tërësia e trojeve, kalatave, godinave dhe çdo objekt tjetër i paluajtshëm në territorin e portit të peshkimit apo qendrës së peshkimit, përfshirë muret rrethuese të tij dhe akuatoriumin, instalimet e sinjalizimit, të ndriçimit dhe të komunikimit brenda territorit të portit dhe në kanalin hyrës.

22/2. “Infrastruktura që lidhet me peshkimin” është ajo pjesë e infrastrukturës së peshkimit, e cila përbëhet nga merkatot, shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit dhe depozitat e karburantit, të cilat janë ndihmuese në zhvillimin e aktivitetit të peshkimit.”.

2. Pika 63 ndryshohet si më poshtë:

“63. “Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal” është peshkimi tregtar që zhvillohet nga anije më të vogla se 12 metra dhe që nuk përdorin vegla peshkimi fundor, me ose pa timon, vegla peshkimi me tërheqje të peshkimit pelagjik me timon ose çift pelagjik, rrjeta binjake me timon dhe draga hidraulike.”.

3. Pas pikës 64 shtohet pika 64/1 me këtë përmbajtje:

“64/1. “Peshkim pa përdorimin e mjeteve lundruese” janë të gjitha format e peshkimit për zënien apo grumbullimin e peshqve dhe të organizmave detarë/ujorë, të cilët kryhen pa përdorimin e mjeteve lundruese.”.

4. Pas pikës 83 shtohet pika 83/1 me këtë përmbajtje:



“83/1. “Sistem i monitorimit të anijes” janë pajisjet *hardware* dhe *software* dhe pajisjet MTU (*Mobile Transceiver Unit*), të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit, të cilat realizojnë identifikimin e një anijeje, pozicionin e saj gjeografik, datën, orën, kursin, shpejtësinë dhe që mundësojnë transmetimin e të dhënave ndërmjet saj, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe ministrisë, sipas përcaktimeve të nenit 67 të këtij ligji.”

Neni 3

Në nenin 19, pika 3, shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) autorizimin e organeve administrative ose të enteve të tjera për dhënien e së drejtës së peshkimit, të parashikuara në këtë ligj.”

Neni 4

Në nenin 30 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5. A.1. të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Leja e peshkimit tregtar lëshohet, menaxhohet dhe hiqet në përputhje të plotë me procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik dhe përfshihet në kategorinë III.5. A.2, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat e konkurrimit publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 34/1

Peshkimi bregdetar artizanal

1. Me qëllim që të kenë të drejtë të hyjnë në burime, anijet e peshkimit bregdetar artizanal duhet të jenë të përfshira në një nga format e organizimit, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 58, të këtij ligji, me qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin e peshkimit artizanal në shkallë të vogël.

2. Organizatat, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të jenë të vetme ose të përfshira në kuadër të organizimeve më të gjera dhe që veprojnë në nivel kombëtar ose rajonal.

3. Aplikimi për leje peshkimi, sipas pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji, bëhet në përputhje me planin e menaxhimit të zonës në fjalë.”

Neni 6

Në nenin 44, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës–argëtues dhe mënyra e lëshimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 7

Në nenin 60, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“d) kryejnë aktivitete të mbrojtjes së burimeve dhe mbikëqyrjes, duke caktuar personel për këtë qëllim;

dh) zhvillojnë struktura mbështetëse tokësore për aktivitetet prodhuese (tregjet e vogla të peshkut, qendrat e grumbullimit dhe të depozitimit të produkteve, mjetet e transportit etj.);

e) promovojnë nisma për të rritur cilësinë e zënieve nga ana e anëtarëve, duke ruajtur vlerat natyrore të zonave.”

Neni 8

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61

Organizatrat e prodhuesve

1. Organizatat prodhuese të peshkimit, të njohura sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit.

2. Në momentin e njohjes së organizatës prodhuese nga ministri, duhet të mbahet parasysh



gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.”.

Neni 9

Pas nenit 61 shtohen nenet 61/1 dhe 61/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 61/1

Objektivat e organizatave të prodhuesve

1. Organizatat prodhuese, në sektorin e peshkimit, ndjekin këta objektiva:

a) nxisin ushtrimin e aktiviteteve të peshkimit fitimprurës e të qëndrueshëm nga anëtarët e tyre, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, duke respektuar politikën sociale dhe pjesëmarrjen në menaxhimin e burimeve peshkore, nëse është e nevojshme;

b) parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur zëniet jo objekt peshkimi të popullatave tregtare dhe, kur është e nevojshme, bëjnë përdorimin më të mirë, pa krijuar treg për zëniet që janë nën dimensionet minimale, të përcaktuara për mbrojtje, sipas akteve nënligjore;

c) kontribuojnë në gjurmueshmërinë e produkteve të peshkimit, me qëllim që konsumatori të ketë një qasje dhe informacion të qartë e të plotë;

ç) kontribuojnë në eliminimin e praktikave të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

2. Përveç objektivave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, organizatat prodhuese ndjekin dy ose më shumë objektiva, si më poshtë:

a) përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës të anëtarëve të tyre;

b) përmirësojnë performancën ekonomike;

c) stabilizojnë tregjet;

ç) kontribuojnë në furnizimin me ushqim, promovojnë standarde të larta të cilësisë e sigurisë ushqimore dhe, në të njëjtën kohë, promovojnë punësimin në zonat bregdetare dhe rurale;

d) zvogëlojnë ndikimin mjedisor të peshkimit, duke përfshirë masat për përmirësimin e selektivitetit të mjeteve të peshkimit.

3. Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues.

Neni 61/2

Objektivat e organizatave të peshkimit bregdetar artizanal

1. Organizatat e peshkimit bregdetar artizanal organizohen në një nga format e parashikuara në këtë ligj dhe kanë këta objektiva:

a) hartojnë dhe zbatojnë një plan menaxhimi për burimet dhe kategoritë ujore, duke mbajtur parasysh edhe specifikat lokale, me ndihmën e kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe interesat e kategorive të tjera të peshkatarëve ose grupeve të tjera të interesit, që veprojnë në bregdet. Gjithashtu, kryejnë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me standardet e vetërregullimit;

b) kryejnë aktivitete të mbrojtjes së burimeve dhe mbikëqyrjes, duke caktuar personel për këtë qëllim;

c) promovojnë iniciativa që synojnë eliminimin e konflikteve me aktivitetet e tjera të peshkimit të kryera në zonën në fjalë;

ç) zhvillojnë struktura mbështetëse tokësore për aktivitetet prodhuese (tregjet e vogla të peshkut, qendrat e grumbullimit dhe të depozitimit të produkteve, mjetet e transportit etj.);

d) promovojnë nisma për të rritur cilësinë e zënieve nga ana e anëtarëve.

2. Plani i menaxhimit, sipas pikës 1, të këtij neni, miratohet nga ministri.”.

Neni 10

Në nenin 64 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Infrastrukturat e peshkimit mund t'i transferohen në menaxhim një organizate peshkimi, me kërkesën e kësaj të fundit.”.

2. Në pikën 2, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“2. Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit nga një organizatë peshkimi realizohet sipas kriterëve dhe kushteve të mëposhtme.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Kur infrastrukturat e peshkimit i transferohen në menaxhim një organizate peshkimi, kjo e fundit dorëzon në ministri një kopje të bilancit kontabël, së bashku me anekset e tij, të dorëzuar në administratën tatimore.”.



Neni 11

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe format e tij

1. Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit kryhet sipas rasteve dhe formave të përcaktuara nga ky ligj.

2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës menaxhon infrastrukturën e peshkimit, sipas njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) menaxhim i drejtpërdrejtë;

b) menaxhim nëpërmjet shoqatave të peshkimit, konkretisht të organizatave të prodhuesve, kooperativave ose të menaxhimit të peshkimit;

c) menaxhim i infrastrukturave të lidhura me peshkimin nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private;

ç) menaxhim i kombinuar i përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.

3. Kushtet dhe procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit të organizatave të peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Një organizatë menaxhon dhe mirëmban infrastrukturën e peshkimit që i është transferuar, në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) menaxhuesi i infrastrukturës së peshkimit përballon kostot e përdorimit e të mirëmbajtjes;

b) infrastruktura e peshkimit përdoret në mënyrë të drejtë e të barabartë, për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;

c) infrastruktura e peshkimit administrohet në mënyrë racionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm.

5. Në rastin kur infrastruktura e peshkimit i është transferuar një organizate, veprohet si më poshtë:

a) çdo mjet lundrues, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, lejohet të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar organizatës;

b) personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, lejohen të hyjnë në port ose në qendrën e peshkimit;

c) çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin apo qendrën e peshkimit që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit dhe me rregulloret e organizatës;

ç) tarifat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi i tyre.

6. Niveli i tarifave propozohet nga organizata dhe miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për financat.”

Neni 12

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës

1. Në varësi të ministrisë krijohet institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.

2. Përveç sa është përcaktuar në pikën 3, të nenit 65, të këtij ligji, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës menaxhon qendrat e ripopullimit të kategorive ujore në varësi të ministrisë.

3. Organizimi dhe funksionimi i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 13

Në nenin 135 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 2; 9; 11, pika 1; 18, pika 5; 24, pika 4; 30, pika 7; 37, pika 1; 52, pika 3; 65, pika 3; 66, pika 3; 72, pika 8; 74, pika 4; 77, pika 3; 82, pika 2; 85, pika 2;



93, pikat 4 e 5; 100, pika 1; 101, pika 2; 112, pika 3; 113, pika 1; 116; 118, pika 3; dhe 119, pika 2, të këtij ligji.”

2. Në pikën 2 hiqen fjalët “65, pikat 2 e 4”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për peshkimin dhe ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 6, të nenit 65, të këtij ligji.”

4. Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji miratohen brenda një afati prej 12 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në

datën 7.2.2019

Shpallur me dekretin nr. 11080, datë 20.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ

Nr. 5/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 124/2015 “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË”

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Auditues energjetik” është një person

fizik i certifikuar ose person juridik që, ka të punësuar auditues energjie të certifikuar, i cili kryen auditime energjetike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”

Neni 2

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjetikë të certifikuar ose nga persona juridikë, që kanë të punësuar auditues energjetikë të certifikuar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Audituesi energjetik

1. Audituesi energjetik, për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik, pajiset me certifikatë nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, e cila mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Audituesi energjetik detyrohet të regjistrojë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik.

4. Agjencia për Efiçencën e Energjisë mban regjistrin kombëtar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet si auditues energjetikë.

5. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, që, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin



energjetik.

6. Audituesi energjetik mban konfidenciale të gjitha të dhënat lidhur me personin fizik ose juridik, të përfutuara në kuadrin e auditimit të kryer në objektet energjetike të këtij personi. Audituesi energjetik nuk duhet të përfitojë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë në interes ose në dëm të subjektit të audituar apo të një pale të tretë. Detyrimi i konfidencialitetit mund të hiqet me miratimin me shkrim nga personi fizik ose juridik, objekt i auditimit energjetik, ose nëse bërja publike e tyre parashikohet nga një ligj tjetër.

7. Agjencia për Eficiencën e Energjisë, me iniciativën e saj, pas një procedure në përputhje me legjislacionin në fuqi, që i garanton audituesit të certifikuar të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u ankuar lidhur me shkeljen, vendos revokimin e certifikatës të audituesit energjetik në rast se:

a) provohet se në procesin e auditimit energjetik janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore;

b) provohet se audituesi bën publik informacionin dhe të dhënat e shoqërisë, si dhe sekretet tregtare të konsumatorëve, me të cilat ai është njohur për shkak të auditimit, me kusht që publikimi i tyre të jetë ankimuar nga subjekti i audituar.

8. Agjencia për Eficiencën e Energjisë njofton me shkrim audituesin energjetik për vendimin e tij për revokimin e certifikatës, sipas pikës 7 të këtij neni.

9. Një auditues energjetik, të cilit i është revokuar certifikata, sipas pikës 7, të këtij neni, ka të drejtë të aplikojë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.”

Neni 4

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shërbimet energjetike ofrohen nga persona juridikë që certifikohen nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Agjencia për Eficiencën e Energjisë mban,

Faqe | 738

përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të ofruesve të shërbimeve energjetike.”.

2. Në pikën 3, pas fjalës “miraton” shtohet fjala “procedurën”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Agjencia për Eficiencën e Energjisë mban regjistrin kombëtar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitete si ofrues të shërbimeve energjetike.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 7.2.2019

Shpallur me dekretin nr. 11081, datë 20.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

**LIGJ
Nr. 6/2019**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
STATUSORE NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EVROPIAN MBI VEPRIMET E
NDËRMARRA NGA AGJENCIA E ROJËS
BREGDETARE DHE KUFIRIT
EVROPIAN NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.2.2019

Shpallur me dekretin nr. 11082, datë 20.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

**MARRËVESHJA STATUSORE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI
VEPRIMET E NDËRMARRA NGA
AGJENCIA E ROJËS BREGDETARE DHE
KUFIRIT EVROPIAN NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË,
nga njëra anë dhe
BASHKIMI EVROPIAN,
nga ana tjetër
në vijim të referuara si “Palët”,

ndërsa mund të lindin situata ku Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në vijim referuar “Agjencia” si strukturë e Bashkimit Evropian, koordinon bashkëpunimin operacional ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së dhe Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë veprimet operationale në territorin e Republikës së Shqipërisë,

ndërsa duhet të krijohet një kuadër ligjor në formën e një marrëveshjeje statusore për situatat kur anëtarët e ekipit të Agjencisë mund të kenë kompetenca ekzekutive në territorin e Republikës së Shqipërisë,

duke pasur parasysh se të gjitha veprimet e Agjencisë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të respektojnë plotësisht të drejtat themelore dhe aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë,

kanë vendosur të lidhin marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Objekti

1. Kjo Marrëveshje do të mbulojë të gjitha aspektet e nevojshme për kryerjen e veprimeve nga

Agjencia që mund të zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, me anë të së cilës anëtarët e ekipit të Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian kanë kompetenca ekzekutive.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Statusi dhe përcaktimi, sipas legjislacionit ndërkombëtar, i territoreve përkatëse të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republika e Shqipërisë nuk ndikohen në asnjë mënyrë nga kjo Marrëveshje, as nga ndonjë akt i përmbushur në zbatim të saj nga Palët apo në emrin e tyre, duke përfshirë krijimin e planeve operationale apo pjesëmarrjen në operationet ndërkufitare.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Veprim” nënkupton një operation të përbashkët, ndërhyrje të shpejtë kufitare ose operation kthimi;

2. “Operation i përbashkët” nënkupton një veprim që synon trajtimin e emigracionit të paligjshëm ose krimin ndërkufitar, ose që synon të sigurojë asistencë teknike dhe operationale në kufirin e Republikës së Shqipërisë fqinjë me një Shtet Anëtar dhe të dislokuar në territorin e Republikës së Shqipërisë;

3. “Ndërhyrje e shpejtë kufitare” nënkupton një veprim që synon të përgjigjet shpejt ndaj një situatë të sfidave specifike dhe jo-proporcionale në kufijtë e Republikës së Shqipërisë fqinje me një Shtet Anëtar dhe të dislokuar në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të kufizuar kohore;

4. “Operation kthimi” nënkupton një operation që koordinohet nga Agjencia dhe përfshin përforsim teknik dhe operational që ofrohet nga një ose më shumë Shtete Anëtare, sipas të cilit të kthyerit nga një ose më shumë Shtete Anëtare kthehen në Republikën e Shqipërisë ose mbi baza të detyruara, ose vullnetare;

5. “Kontroll kufitar” nënkupton kontrollin e personave të kryer në një kufi në përgjigje ekskluzivisht për qëllimin për të kaluar ose për kalimin e atij kufiri, pavarësisht nga ndonjë konsideratë tjetër, i cili përbëhet nga kontrollat kufitare në pikat e kalimit kufitar dhe mbikëqyrjen kufitare ndërmjet pikave të kalimit kufitar;

6. “Anëtar ekipi” nënkupton një anëtar ose të



personelit të Agjencisë, ose një anëtar të ekipit të rojeve kufitare dhe personel tjetër përkatës nga Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, duke përfshirë rojet kufitare dhe personelin tjetër përkatës që nënkontraktohet nga Shtetet Anëtare në Agjenci për t'u dislokuar gjatë një aksioni;

7. “Shtet Anëtar” nënkupton një Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian;

8. “Shtet Anëtar i origjinës” nënkupton Shtetin Anëtar, anëtari i ekipit të të cilit është roje kufitare ose anëtar tjetër i personelit përkatës;

9. “Të dhëna personale” nënkupton çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm; një person i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti duke iu referuar një identifikuesi si një emër, numër identifikimi, të dhëna për vendndodhjen, identifikues on-line ose një ose më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të atij personi fizik;

10. “Shtet Anëtar pjesëmarrës” nënkupton një Shtet Anëtar që merr pjesë në veprim në Republikën e Shqipërisë, duke ofruar pajisje teknike, roje kufitare dhe personel tjetër përkatës të dislokuar si pjesë të ekipit;

11. “Agjenci” nënkupton Agjencinë e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian, të themeluar nga Rregullorja (BE) 2016/1624 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian¹;

12. “Kompetenca ekzekutive të një anëtari të ekipit” nënkupton kompetencat e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara për kontrollin kufitar dhe operacionet e kthimit, të cilat zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë veprimeve të përbashkëta, siç përfshihet në Planin Operacional;

13. “Forcë madhore” përfshin, pa kufizim, çdo akt lufte (qoftë i deklaruar ose jo), pushtim, konflikt i armatosur ose veprim i armikut të huaj, bllokadë, trazirë, terrorizëm ose ushtrim të fuqisë ushtarake,

ndonjë tërmet, përmbytje, zjarr, stuhi ose fatkeqësi natyrore, dhe sa herë që ndodh, çdo ngjarje apo rrethanë të ngjashme me sa më sipër.

Neni 3

Plan operacional

1. Një Plan Operacional që ka miratimin nga Shteti Anëtar ose Shtetet Anëtare në kufi me zonat operacionale. duhet të bihet dakord ndërmjet Agjencisë dhe Republikës së Shqipërisë për çdo operacion të përbashkët ose për çdo ndërhyrje të shpejtë kufitare.

2. Plani duhet të përcaktojë hollësisht aspektet organizative dhe procedurale të operacionit të përbashkët ose ndërhyrjes së shpejtë kufitare, duke përfshirë një përshkrim dhe vlerësim të situatës, qëllimin dhe objektivat operacionale, konceptin operacional, llojin e pajisjeve teknike që do të dislokohen, planin e zbatimit, bashkëpunimin me vendet e tjera të treta, Agjencitë dhe organet e tjera të Bashkimit Evropian ose organizatat ndërkombëtare, dispozitat në lidhje me të drejtat themelore, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, koordinimin, komandën, kontrollin, strukturën e komunikimit dhe raportimit, masat organizative dhe logjistikë, vlerësimin dhe aspektet financiare të operacionit të përbashkët ose ndërhyrjes së shpejtë kufitare.

3. Vlerësimi i operacionit të përbashkët ose i ndërhyrjes së shpejtë kufitare kryhet bashkërisht nga Republika e Shqipërisë dhe Agjencia.

Neni 4

Detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të ekipit

1. Anëtarët e ekipit do të kenë autoritetin për të kryer detyrat dhe ushtruar kompetencat ekzekutive të kërkuara për operacionet e kontrollit kufitar dhe operacionet e kthimit.

2. Anëtarët e ekipit duhet të respektojnë ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë.

3. Anëtarët e ekipit mund të kryejnë vetëm detyrat dhe ushtrajnë kompetencat në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas udhëzimeve dhe, si rregull i përgjithshëm, në prani të rojeve kufitare ose personelit tjetër përkatës të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë, sipas rastit, do t'i lëshojë udhëzime ekipit në përputhje me Planin Operacional. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë në mënyrë të jashtëzakonshme anëtarët e ekipit që të veprojnë në emër të saj.

¹ Rezoluta 2016/1624 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 shtator 2016 mbi rojet bregdetare evropiane dhe ndryshimin e Rregullores (EU) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 863/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2007/2004 dhe vendimi i Këshillit 2005/267/EC (OJ L 251, 16.9.2016, f. 1).



Agjencia, nëpërmjet Zyrtarit të saj Koordinues, mund t'i komunikojë pikëpamjet e veta Republikës së Shqipërisë sipas udhëzimeve të dhëna ekipit. Në këtë rast, Republika e Shqipërisë do t'i marrë këto pikëpamje në konsideratë dhe do t'i ndjekë deri në masën që është e mundur. Në rastet kur udhëzimet e lëshuara për ekipin nuk janë në përputhje me Planin Operacional, Zyrtari Koordinues i raporton menjëherë drejtorit ekzekutiv të Agjencisë (në vijim "drejtor ekzekutiv"). Drejtori ekzekutiv mund të marrë masat e duhura, duke përfshirë pezullimin ose përfundimin e veprimit.

4. Anëtarët e ekipit duhet të mbajnë uniformën e tyre gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre. Gjithashtu, anëtarët e ekipit do të mbajnë identifikim personal të dukshëm dhe një shirit krahu ngjyrë blu me shenjat dalluese të Bashkimit Evropian dhe të Agjencisë. Për qëllimet e identifikimit në lidhje me autoritetet kombëtare të Republikës së Shqipërisë, anëtarët e ekipit në çdo kohë duhet të mbajnë një dokument akreditimi të përmendur në nenin 7.

5. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, anëtarët e ekipit mund të mbajnë armë shërbimi, municione dhe pajisje të autorizuar sipas ligjit kombëtar të Shtetit Anëtar të origjinës. Republika e Shqipërisë, para dislokimit të anëtarëve të ekipit, duhet të informojë Agjencinë për armët e lejuara të shërbimit, municionin dhe pajisjet, si dhe për kuadrin përkatës ligjor dhe kushtet e përdorimit të tyre.

6. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, anëtarët e ekipit do të autorizohen të përdorin forcën, duke përfshirë armët e shërbimit, municionin dhe pajisjet, me pëlqimin e Shtetit Anëtar të origjinës dhe Republikës së Shqipërisë, në prani të rojeve kufitare ose personelit tjetër përkatës të Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me ligjin kombëtar të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë anëtarët e ekipit që të përdorin forcën në mungesë të rojeve kufitare ose personelit tjetër përkatës të Republikës së Shqipërisë. Autoriteti për të dhënë pëlqimin e Shteteve anëtare të origjinës, do të përcaktohet në Planin Operacional.

7. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë anëtarët e ekipit që të konsultojnë bazat e të dhënave kombëtare, nëse është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve operacionale të

përcaktuara në Planin Operacional dhe operacionet e kthimit. Anëtarët e ekipit do të konsultojnë vetëm të dhënat që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, siç specifikohet në Planin Operacional apo që janë të nevojshme për operacionet e kthimit. Republika e Shqipërisë, përpara dislokimit të anëtarëve të ekipit, duhet të njoftojë Agjencinë për bazat e të dhënave kombëtare për të cilat mund të konsultohen. Ky konsultim do të kryhet në përputhje me ligjin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi i aksionit

1. Drejtori Ekzekutiv mund të pezullojë ose përfundojë veprimin pas informimit të Republikës së Shqipërisë me shkrim. Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose Planit Operacional nuk respektohen nga Republika e Shqipërisë. Drejtori ekzekutiv do të njoftojë Republikës së Shqipërisë arsyet e tij.

2. Republika e Shqipërisë mund të pezullojë ose ndërpresë veprimin, pasi të informojë Agjencinë me shkrim nëse dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose Planit Operacional nuk respektohen nga Agjencia ose nga ndonjë Shtet Anëtar pjesëmarrës. Republika e Shqipërisë do të njoftojë Agjencinë për arsyet e saj.

3. Në veçanti, drejtori ekzekutiv ose Republika e Shqipërisë mund të pezullojë ose të përfundojë veprimin në rastet e shkeljes së të drejtave themelore, shkeljes së parimit të moskthimit ose rregullave të mbrojtjes së të dhënave.

4. Ndërprerja e veprimit nuk do të ndikojë në të drejtat ose detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose i Planit Operacional para këtij përfundimi.

Neni 6

Privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të ekipit

1. Dokumentet, korrespondenca dhe asetet e anëtarëve të ekipit do të jenë të pacenueshme, përveç në rastet e masave të ekzekutimit, të cilat lejohen sipas paragrafit 7.

2. Anëtarët e ekipit gëzojnë imunitet nga juridiksioni penal i Republikës së Shqipërisë në kuadrin e akteve të kryera në ushtrimin e funksioneve zyrtare të anëtarit të përmbushura në përputhje me planin operacional.



Në rastin e dyshimit të kryerjes së një veprë penale nga një anëtar ekipi, drejtori ekzekutiv dhe autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës duhet të njoftohen menjëherë. Para fillimit të procedimit në gjykatë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të çdo përfaqësimi të bërë nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës dhe autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë, drejtori ekzekutiv vërteton në gjykatë nëse vepra në fjalë është kryer gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare të anëtarit gjatë veprimeve të ndërmarra në përputhje me planin operacional. Në pritje të vërtetimit/certifikimit nga drejtori ekzekutiv Agjencia dhe Shteti Anëtar i origjinës nuk do të marrin ndonjë masë që mund të rrezikojë ndjekjen penale të mundshme të anëtarit të ekipit nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.

Nëse vepra është kryer në ushtrimin e funksioneve zyrtare, procedimi nuk do të fillojë. Nëse vepra nuk është kryer në ushtrimin e funksioneve zyrtare, atëherë procedimi mund të vazhdojë. Vërtetimi nga drejtori ekzekutiv do të jetë detyrues për juridiksionin e Republikës së Shqipërisë. Privilegjet e dhëna anëtarëve të ekipit dhe imuniteti nga juridiksioni penal i Republikës së Shqipërisë nuk i përjashton ata nga juridiksioni i Shtetit Anëtar të origjinës.

3. Anëtarët e ekipit do të gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ i Republikës së Shqipërisë në lidhje me të gjitha veprimet e kryera prej tyre në ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare sipas planit operacional. Nëse kundër anëtarëve të ekipit fillon ndonjë procedim përpara një gjykate të Republikës së Shqipërisë, drejtori ekzekutiv dhe autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës do të njoftohen menjëherë. Para fillimit të procedimit para gjykatës, pas shqyrtimit të kujdesshëm të çdo përfaqësimi të bërë nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës dhe autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, drejtori ekzekutiv i Agjencisë duhet të vërtetojë në gjykatë nëse vepra në fjalë është kryer nga Anëtarët e ekipit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare në përputhje me planin operacional.

Nëse vepra është kryer gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare, procedimi nuk do të fillojë. Nëse vepra nuk është kryer gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare, procedimi mund të vazhdojë. Vërtetimi nga drejtori ekzekutiv do të jetë detyrues për juridiksionin e Republikës së Shqipërisë. Fillimi

i procedimeve nga anëtarët e ekipit do t'i pengojë ata të kërkojnë imunitet nga juridiksioni në lidhje me ndonjë kundërpadi të lidhur drejtpërdrejt me padinë kryesore.

4. Vendi anëtar i origjinës mund të heqë dorë nga imuniteti i anëtarëve nga juridiksioni civil, penal dhe administrativ i Republikës së Shqipërisë, sipas rastit. Një heqje e tillë dorë duhet të jetë gjithmonë e shprehur.

5. Anëtarët e ekipit nuk janë të detyruar të japin dëshmi si dëshmitarë.

6. Në rast të dëmtimit të shkaktuar nga një anëtar i një ekipi gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare gjatë veprimeve të kryera në përputhje me planin operacional, Republika e Shqipërisë është përgjegjëse për çdo dëm.

Në rast të dëmtimit të shkaktuar nga neglizhenca e rëndë ose sjellja e papërshtatshme ose nëse akti nuk është kryer në ushtrimin e funksioneve zyrtare nga një anëtar i ekipit nga një Shtet Anëtar, Republika e Shqipërisë mund të kërkojë, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, që kompensimi të paguhet nga shteti anëtar pjesëmarrës në fjalë.

Në rast të dëmtimit të shkaktuar nga neglizhenca e rëndë ose sjellja e papërshtatshme ose nëse akti nuk është kryer në ushtrimin e funksioneve zyrtare nga një anëtar i ekipit që është anëtar i personelit të Agjencisë, Republika e Shqipërisë mund të kërkojë që kompensimi të paguhet nga Agjencia. Në rast dëmtimi të shkaktuar në Republikën e Shqipërisë për shkak të forcës madhore, as Republika e Shqipërisë, as Shteti Anëtar pjesëmarrës, as Agjencia nuk do të mbajnë përgjegjësi.

7. Asnjë masë ekzekutimi nuk mund të merret në lidhje me anëtarët e ekipit, përveç në rastet kur një procedim civil që nuk lidhet me funksionet e tyre zyrtare ka filluar kundër tyre. Prona/pasuria e anëtarëve të ekipit, e cila është e vërtetuar nga drejtori ekzekutiv si e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, nuk do të konfiskohet për përmbushjen e një vendimi ose urdhri. Në procedimet civile, anëtarët e ekipit nuk do të jenë subjekt i ndonjë kufizimi të lirisë së tyre personale ose ndonjë mase tjetër kufizimi.

8. Imuniteti i anëtarëve të ekipit nga juridiksioni i Republikës së Shqipërisë nuk i përjashton ata nga juridiksionet e Shteteve Anëtare përkatëse të



originës.

9. Anëtarët e ekipit, në lidhje me shërbimet e ofruara për Agjencinë, do të përjashtohen nga dispozitat sociale të sigurisë që mund të jenë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

10. Anëtarët e ekipit përjashtohen nga çdo formë e tatimit në Republikën e Shqipërisë për pagën dhe shpërblimet që u paguhen nga Agjencia ose shtetet anëtare të origjinës, si dhe për çdo të ardhur të marrë nga jashtë Republikës së Shqipërisë.

11. Republika e Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret që mund të miratojë, do të lejojë hyrjen e neneve për Përdorimin personal të anëtarëve të ekipit dhe do të lejojë përjashtimin nga të gjitha tatimet doganore, taksat dhe tarifat e tjera përveç tarifave për ruajtjen, transportin dhe shërbime të ngjashme, në lidhje me këta artikuj. Gjithashtu, Republika e Shqipërisë do të lejojë eksportin e artikujve të tillë.

12. Bagazhi personal i anëtarëve të ekipit mund të inspektohet vetëm në rastet e dyshimeve të justifikuara se përmban artikuj që nuk janë për përdorim personal të anëtarëve të ekipit ose artikuj, importi ose eksporti i të cilëve është i ndaluar me ligj ose në bazë të rregullave të karantinës së Republikës së Shqipërisë. Inspektimi i këtyre bagazheve personale do të kryhet vetëm në prani të anëtarit/anëtarëve të ekipit përkatës ose një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë.

Neni 7

Dokumenti i akreditimit

1. Agjencia, në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, lëshon një dokument në gjuhët zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në një gjuhë zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian për secilin anëtar të ekipit, për qëllimet e identifikimit në lidhje me autoritetet kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe si dëshmi të të drejtave të mbajtësit për të kryer detyrat dhe ushtruar kompetencat e përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje dhe në Planin Operacional. Dokumenti i akreditimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm për anëtarin e ekipit: emrin dhe shtetësinë, titullin e gradës ose pozicionit të punës, një fotografi të digjitalizuar të kohëve të fundit dhe detyra të autorizuar për t'u kryer gjatë dislokimit.

2. Dokumenti i akreditimit, në kombinim me

një dokument udhëtimi të vlefshëm, i jep anëtarit të ekipit të drejtën për të hyrë në Republikën e Shqipërisë pa pasur nevojë për vizë ose autorizim paraprak.

3. Dokumenti i akreditimit i kthehet Agjencisë në fund të aksionit. Autoritetet kompetente shqiptare do të njoftohen në lidhje me këtë.

Neni 8

Të drejtat themelore

1. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre, anëtarët e ekipit duhet të respektojnë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë në lidhje me qasjen në procedurat e azilit, dinjitetin njerëzor dhe ndalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor ose poshtërues, të drejtën për liri, parimin e moskthimit dhe ndalimin e dëbimeve kolektive, të drejtat e fëmijës dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Gjatë kryerjes së detyrave dhe kompetencave të tyre, ata nuk do të diskriminojnë arbitrarisht personat për çfarëdo lloj arsyeje, duke përfshirë seksin, origjinën raciale ose etnike, fenë ose besimin, aftësinë e kufizuar, moshën, orientimin seksual ose identitetin gjinor. Çdo masë që ndërhyr në të drejtat dhe liritë themelore të marra në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre duhet të jetë në raport me objektivat e ndjekura nga masa të tilla dhe duhet të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore.

2. Secila Palë do të ketë një mekanizëm ankimi për trajtimin e pretendimeve për shkelje të të drejtave themelore të kryera nga personeli i saj gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare gjatë një operacioni të përbashkët, ndërhyrjes së shpejtë kufitare ose operacionit të kthimit të kryera sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Përpunimi i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale bëhet vetëm kur është i nevojshëm për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga Republika e Shqipërisë, Agjencia ose Shtetet Anëtare pjesëmarrëse.

2. Përpunimi i të dhënave personale nga Republika e Shqipërisë i nënshtrohet ligjeve të tij kombëtare.

3. Përpunimi i të dhënave personale nga



Agjencia dhe shteti/et anëtare pjesëmarrëse për qëllime administrative, përfshirë në rastin e transferimit të të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, i nënshtrohet Rregullores (KE) nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 18 dhjetor 2000 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave¹ Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, me të cilën shfuqizohet Direktiva 95/46/KE (Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave të përgjithshme)², Direktivës (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga autoritetet kompetente me qëllim të parandalimit, hetimit, zbulimit ose përndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të dënimeve penale, si edhe për lëvizjen e re të këtyre të dhënave, me të cilën shfuqizohet vendimi 2008/977/JHA³ dhe masat e ndërmarra nga Agjencia për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 45/2001 të referuara në nenin 45 (2) të Rregullores (BE) 2016/1624.

4. Në rast se përpunimi përfshin transferimin e të dhënave personale, Shtetet Anëtare dhe Agjencia do të tregojnë, në momentin e transferimit të të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, çdo kufizim mbi qasjen në të ose përdorimin e tij, në kushte të përgjithshme ose specifike, duke përfshirë në lidhje me transferimin, fshirjen ose shkatërrimin. Kur nevoja për kufizime të tilla bëhet e dukshme pas transferimit të të dhënave personale, ata do të informojnë Republikën e Shqipërisë në përputhje me rrethanat.

5. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime administrative gjatë veprimeve mund të përpunohen nga Agjencia. Shtetet Anëtare pjesëmarrëse dhe Republika e Shqipërisë në përputhje me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

6. Agjencia, Shtetet Anëtare pjesëmarrëse dhe Republika e Shqipërisë do të hartojnë një raport të përbashkët për zbatimin e paragrafëve 1 deri 5 të

këtij neni në fund të çdo veprimi. Ky raport i dërgohet Zyrtarit të Agjencisë së të Drejtave Themelore dhe Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave. Ata do t'i raportojnë drejtorit ekzekutiv.

Neni 10

Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes

1. Autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në Republikën e Shqipërisë do të jetë Ministria e Brendshme.

2. Autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të jetë Agjencia.

Neni 11

Mosmarrëveshjet dhe zgjidhja

1. Të gjitha çështjet që lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të shqyrtohen bashkërisht nga përfaqësuesit e Agjencisë dhe autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të konsultohen me Shtetin Anëtar ose Shtetet Anëtare fqinjë të Republikës së Shqipërisë.

2. Në mungesë të ndonjë zgjidhjeje paraprake, mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen ekskluzivisht nëpërmjet negocimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, i cili do të konsultohet me çdo Shtet Anëtar fqinj me Republikën e Shqipërisë.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje duhet t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga Palët, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme dhe Palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit gjatë së cilit, pas kryerjes së njoftimit të fundit i përcaktuar në paragrafin I.

3. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një kohë të pacaktuar. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë apo pezullohet me anë të një miratimi me shkrim ndërmjet Palëve ose në mënyrë të njëanshme nga njëra Palë. Në këtë rast, pala që dëshiron ta përfundojë apo pezullojë, do të njoftojë

¹ OJ EU L 8, 12.1.2001, f. 1.

² OJ EU L 119, 4.5.2016, f. 1

³ OJ EU L 119, 4.5.2016, f. 89



me shkrim palën tjetër në lidhje me këtë. Përfundimi/zgjidhja e marrëveshjes do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë në vijim të muajit të dhënies së njoftimit ose pas përfundimit të miratimit me shkrim midis Palëve.

4. Njoftimet e bëra në përputhje me këtë nen do t'i dërgohen, në rastin e Bashkimit Evropian, Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe, në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrisë përgjegjëse për Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Hartuar në kopje identike në gjuhët shqipe, bullgare, kroate, çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, frënge, gjermane, greke, hungareze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, rumune, sllovaqe, sllovene, spanjolle dhe suedeze, secili prej këtyre teksteve është njëloj autentik.

LIGJ Nr. 7/2019

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Protokollin i Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2019

Shpallur me dekretin nr. 11083, datë 20.2.2019 të Presidentit të Republikës së

Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLL

I TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Palët e Traktatit të Atlantikut Verior kanë nënshkruar në Uashington, më 4 prill 1949.

duke qenë të bindura se siguria e zonës së Atlantikut Verior do të rritet me aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë Traktat,

bien dakord si më poshtë vijon:

Neni I

Me hyrjen në fuqi të këtij Protokollin, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior i njofton Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, në emër të të gjitha Palëve, ftesën për t'u pranuar në Traktatin e Atlantikut Verior. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet Palë në datën kur depoziton instrumentin e saj të aderimit te Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni II

Ky Protokoll hyn në fuqi kur secila nga Palët e Traktatit të Atlantikut Verior ka njoftuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pranimin e saj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon Palët e Traktatit të Atlantikut Verior mbi datën e marrjes së këtij njoftimi, si dhe datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollin.

Neni III

Ky Protokoll ku tekstet në gjuhën angleze dhe frënge janë njëloj autentike, depozitohet në Arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kopjet e njësuara me Protokollin dërgohen nga Qeveria e SHBA-ve te qeveritë e të gjitha Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit e pajisur me plotfuqi kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Nënshkruar në Bruksel, më 6 shkurt 2019.

Për Republikën e Shqipërisë
Për Mbretërinë e Belgjikës
Për Republikën e Bullgarisë



Për Kanadanë
 Për Republikën e Kroacisë
 Për Republikën Çeke
 Për Mbretërinë e Danimarkës
 Për Republikën e Estonisë
 Për Republikën e Francës
 Për Republikën Federale të Gjermanisë
 Për Republikën e Greqisë
 Për Hungarinë
 Për Republikën e Islandës
 Për Republikën e Italisë
 Për Republikën e Letonisë
 Për Republikën e Lituanisë
 Për Dukatin e Madh të Luksemburgut
 Për Malin e Zi
 Për Mbretërinë e Holandës
 Për Mbretërinë e Norvegjisë
 Për Republikën e Polonisë
 Për Republikën e Portugalisë
 Për Rumaninë
 Për Republikën e Sllovakisë
 Për Republikën e Sllovenisë
 Për Mbretërinë e Spanjës
 Për Republikën e Turqisë
 Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së
 Madhe dhe Irlandës së Veriut
 Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vula e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, datë 6.2.2019, është për të vërtetuar se ky dokument (i përbërë nga 9 fletë) është kopje e njëjtë me origjinalin.

Bruksel, 6 shkurt 2019

URDHËR
Nr. 56, datë 15.2.2019

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË
 STANDARDIT KOMBËTAR TË
 KONTABILITETIT NR. 15 “PËR
 KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN
 FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE
 EKONOMIKE, I PËRMIRËSUAR”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të nenit 11, pika 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

Faqe | 746

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike” i përmirësuar (SKK 15).

2. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 15, i përmirësuar, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 1.1.2019. Ndryshimet zbatohen në prospektivë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
 DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 88, datë 18.2.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN
 NR. 41, DATË 24.1.2019 TË MINISTRIT TË
 ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
 “PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
 PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
 ANËTARËVE TË BORDIT TË
 ADMINISTRIMIT, MËNYRËN E
 VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE
 DHE AFATIN E DORËZIMIT
 TË DOKUMENTACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 41, datë 24.1.2019 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 3 riformulohet në këtë mënyrë:

“Për kandidatët anëtarë të Bordit të Administrimit, në institucionet publike të arsimit të



lartë, afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë deri në datën 26.2.2019.”

b) Në pikën 4 të shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, togfjalëshi “Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet brenda datës 15.2.2019...” të ndryshohet në “Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 26.2.2019...”.

c) Në fund të pikës 5 të shtojcës nr. 1, shtohet fjalia si më poshtë:

“Dalja e rezultateve përfundimtare të konkurrimit për kandidatët e institucioneve publike të arsimit të lartë, do të bëhet brenda datës 8.3.2019.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM

PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES TË MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrit nr. 41, datë 24.1.2019 të MASR “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit për 12 institucionet publike të arsimit të lartë, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për bord
-----	--	----------------------------

1	Universiteti i Tiranës	2
2	Universiteti Politeknik i Tiranës	3
3	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3
4	Universiteti Bujqësor i Tiranës	3
5	Universiteti i Arteve, Tiranë	3
6	Universiteti i Sporteve të Tiranës	3
7	Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”	3
8	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	3
9	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	3
10	Universiteti “Fan Noli”, Korçë	3
11	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	3
12	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	3

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe



mbikëqyr zbatimin e tij;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë shtetas shqiptar.

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.

- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë

- Të ketë integritet etik dhe profesional.

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.

- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL ku kandidon;

- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- Fotokopje të librezës së punës;

- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

- Vërtetim i lëshuar nga gjykata;

- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas



formatit të shtojcës nr. 1/2;

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 26.2.2019 në një nga këto mënyra:

a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila vë në dispozicion të Komisionit “Ad hoc” të ngritur me urdhër Ministri dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

5. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të shpallë kandidatët e kualifikuar në faqen e saj zyrtare, www.arsimi.gov.al.

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “Ad-hoc” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Dalja e rezultateve përfundimtare të konkurrimit do të bëhet brenda datës 8.3.2019.

6. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njërive të qeverisjes qendrore”, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019
Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë